

DIREKTIVA E KËSHILLIT, datë 30 maj 1978, për bashkërendimin e akteve ligjore, nënligjore dhe administrative në lidhje me bashkësigurimin në Komunitet (78/473/KEE)

KËSHILLI I KOMUNITETEVE EUROPIANE,

Duke pasur parasysh Traktatin Themelues të Komunitetit European dhe në veçanti nenin 57 paragrafi 2 dhe nenin 66 të tij,

Duke pasur parasysh propozimin e Komisionit,

Duke pasur parasysh opinionin e Parlamentit European [1],

Duke pasur parasysh opinionin e Komitetit Ekonomik dhe Social (2)

Meqë ndjekja e efektshme e veprimtarisë tregtare të bashkësigurimit në Komunitet është mirë të ndihmohet përmes një minimumi bashkërendimi në mënyrë që të parandalohet shtrembërimi i konkurrencës dhe pabarazia në trajtim, pa prekur lirinë që ekziston në disa Shtete Anëtare;

Meqë një bashkërendim i tillë mbulon vetëm ato operacione të bashkësigurimit të cilat janë ekonomikisht më të rëndësishmet, pra ato operacione të cilat për shkak të natyrës ose të madhësisë kërkojnë mbulim me bashkësigurim ndërkombëtar;

Meqë kjo Direktivë përbën, kështu, një hap të parë drejt bashkërendimit të të gjitha operacioneve që mund të realizohen përmes lirisë për të ofruar shërbime; meqë, në fakt, ky bashkërendim është objekt i propozimit për një Direktivë të dytë të Këshillit për bashkërendimin e akteve ligjore, nënligjore dhe administrative në lidhje me sigurimet e drejtpërdrejta me përjashtim të sigurimit të jetës dhe për dispozitat për mundësimin e ushtrimit të efektshëm të lirisë për të ofruar shërbime, të cilin Komisioni ia ka përcjellë Këshillit më datë 30 dhjetor 1975 (3);

Meqë siguruesi kryesor është më në gjendje se bashkësiguruesit e tjerë të bëjë vlerësimin e kërkesave për dëmshpërblim dhe të caktojë shumën minimale të rezervave për kërkesat për dëmshpërblim pezull;

Meqë po punohet në lidhje me mbylljen e veprimtarisë së ndërmarrjes së sigurimit; meqë duhet bërë një parashikim në këtë fazë për të siguruar që, në rast të mbylljes së veprimtarisë, përfituesit e kontratave të bashkësigurimit në Komunitet të gëzojnë barazi në trajtim me përfituesit e lidhur me veprimtaritë e tjera të sigurimeve, pavarësisht shtetësisë së personave të tillë;

Meqë është mirë të parashikohet një bashkëpunim i posaçëm në fushën e bashkësigurimit në Komunitet ndërmjet autoriteteve kompetente mbikëqyrëse të Shteteve Anëtare dhe ndërmjet këtyre autoriteteve dhe Komisionit; meqë në kuadër të një bashkëpunimi të tillë është mirë të shqyrtohet çdo praktikë që mund të evidentojë keqpërdorim të qëllimit të Direktivës,

KA MIRATUAR KËTË DIREKTIVË:

TITULLI I Dispozita të përgjithshme

Neni 1

1. Kjo Direktivë zbatohet për operacionet e bashkësigurimit në Komunitet të përmendura në nenin 2 të cilat kanë të bëjnë me risqet e klasifikuara në pikën “A” nën-pikat 4, 5, 6, 7, 8, 9, 11, 12, 13 dhe 16 të Shtojcës së Direktivës së Parë të Këshillit, datë 24 korrik 1973, për bashkërendimin e akteve ligjore, nënligjore dhe administrative që kanë të bëjnë me fillimin dhe ndjekjen e veprimtarisë së sigurimit të drejtpërdrejtë me përjashtim të sigurimit të jetës (4) e quajtur më poshtë në këtë Direktivë “Direktiva e Parë për Bashkërendimin”.

Megjithatë, kjo Direktivë nuk zbatohet për operacionet e bashkësigurimit në Komunitet që mbulojnë risqet e klasifikuara në pikën “A” nën-pika 13 të cilat kanë të bëjnë me dëmet e shkaktuara nga burimet bërthamore ose nga produktet mjekësore. Përjashtimi i sigurimit kundër dëmit të shkaktuar nga produktet mjekësore shqyrtohet nga Këshilli brenda pesë vjetëve pas njoftimit të kësaj Direktive.

2. Kjo Direktivë zbatohet për risqet e përmendura në paragrafin e parë të pikës 1 të cilat për shkak të natyrës ose madhësisë kërkojnë pjesëmarrjen e disa siguruesve për mbulimin e tyre.

Çdo vështirësi që mund të lindë gjatë vënies në zbatim të këtij parimi shqyrtohet në përputhje me nenin 8. (1) GZ Nr. C 60, 13.3.1975, f. 16. (2) GZ Nr. C 47, 27.2.1975, f. 40. (3) GZ Nr. C 32, 12.2.1976, f. 2. (4) GZ Nr. L 228, 16.8.1973, f. 3.

Neni 2

1. Kjo Direktivë zbatohet vetëm për ato operacione të bashkësigurimit në Komunitet që përmbushin kushtet e mëposhtme: (a) risku, sipas kuptimit të nenit 1 pika 1, mbulohet me një kontratë të vetme sipas një primi të përgjithshëm dhe për të njëjtën periudhë nga dy a më shumë ndërmarrje sigurimesh, të quajtura më poshtë në këtë Direktivë “bashkësigurues”, secila duke mbuluar pjesën e vet; njëra prej këtyre ndërmarrjeve është siguruesi kryesor;

(b) risku ndodhet brenda Komunitetit;

(c) me qëllim mbulimin e këtij risku, siguruesi kryesor autorizohet në përputhje me kushtet e parashikuara në Direktivën e Parë për Bashkërendimin, domethënë trajtohet sikur të ishte siguruesi që mbulon të gjithë riskun;

(d) të paktën njëri prej bashkësiguruesve merr pjesë në kontratë përmes një zyre qendrore, agjencie ose dege të vendosur në një Shtet Anëtar me përjashtim të Shtetit Anëtar të siguruesit kryesor;

(e) siguruesi kryesor merr plotësisht përsipër rolin e kryesuesit në praktikën e bashkësigurimit dhe në veçanti përcakton kushtet e sigurimit dhe klasifikimin e personit të siguruar.

2. Ato operacione të bashkësigurimit që nuk përmbushin kushtet e parashikuara në pikën 1 ose që mbulojnë risqe që nuk përfshijnë risqet e përcaktuara në nenin 1 vazhdojnë të jenë objekt i ligjeve kombëtare që janë në fuqi në kohën e hyrjes në fuqi të kësaj Direktive.

Neni 3

E drejta e ndërmarrjeve me zyrë qendrore në një Shtet Anëtar që janë objekt dhe përmbushin kërkesat e Direktivës së Parë për Bashkërendimin për të marrë pjesë në bashkësigurimin në Komunitet nuk mund t'i nënshtrohet asnjë dispozite tjetër përveç dispozitave të kësaj Direktive.

TITULLI II Kushtet dhe procedurat për bashkësigurimin në Komunitet

Neni 4

1. Niveli i rezervave teknike përcaktohet nga bashkësiguruesit e ndryshëm në përputhje me rregullat e vendosura nga Shteti Anëtar ku janë vendosur ose, në mungesë të rregullave të tilla, në përputhje me praktikën e vendosura në këtë Shtet. Megjithatë, rezervat për kërkesat për dëmshpërblim pezull duhet të jenë të paktën të barabarta me nivelin e përcaktuar nga siguruesi kryesor në përputhje me rregullat ose praktikën e Shtetit ku është vendosur një sigurues i tillë.

2. Rezervat teknike të krijuara nga bashkësiguruesit e ndryshëm mbulohen me aktive përputhëse. Megjithatë, mund të bëhet një lehtësim i rregullit për aktivet përputhëse nga Shtetet Anëtare ku janë vendosur bashkësiguruesit në mënyrë që të merren në konsideratë kërkesat e administrimit të shëndoshë të ndërmarrjeve të sigurimeve. Aktive të tilla duhet ta kenë vendndodhjen ose në Shtetet Anëtare ku janë vendosur bashkësiguruesit ose në Shtetin Anëtar në të cilin është vendosur siguruesi kryesor, si ta vendosë vetë siguruesi.

Neni 5

Shtetet Anëtare sigurojnë që bashkësiguruesit e vendosur në territorin e tyre të mbajnë të dhëna statistikore ku të tregohet shtrirja e operacioneve të bashkësigurimit në Komunitet dhe vendet e prekura.

Neni 6

Autoritetet mbikëqyrëse të Shteteve Anëtare bashkëpunojnë nga afër në vënien në zbatim të kësaj Direktive dhe vendosin në dispozicion të njëri tjetrit të gjitha informacionet e nevojshme për këtë qëllim.

Neni 7

Në rast të mbylljes së veprimtarisë së ndërmarrjes së sigurimeve, detyrimet e lindura nga pjesëmarrja në kontratat e bashkësigurimit në Komunitet përmbushen njësoj sikur të kishin lindur nga kontratat e tjera të sigurimeve të ndërmarrjes në fjalë, pa bërë dallim për shkak të shtetësisë të personave të siguruar dhe të përfituesve.

TITULLI III Dispozita të fundit

Neni 8

Komisioni dhe autoritetet kompetente të Shteteve Anëtare bashkëpunojnë nga afër në funksion të shqyrtimit të çdo vështirësie që mund të lindë në vënien në zbatim të kësaj Direktive.

Në kuadër të këtij bashkëpunimi ato shqyrtojnë veçanërisht çdo praktikë që mund të tregojë se qëllimi i dispozitave të kësaj Direktive dhe në veçanti i dispozitave të nenit 1 pika 2 dhe nenit 2 po keqpërdoren ose ngaqë siguruesi kryesor nuk po e merr përsipër rolin e kryesuesit në praktikën e bashkësigurimit ose ngaqë duket qartë që risqet nuk kërkojnë pjesëmarrjen e dy apo më shumë siguruesve për t'i mbuluar.

Neni 9

Komisioni i dorëzon Këshillit, brenda gjashtë vjetësh pas njoftimit të kësaj Direktive, një raport për zhvillimin e bashkësigurimit në Komunitet.

Neni 10

Shtetet Anëtare bëjnë shtesat dhe ndryshimet përkatëse në dispozitat e tyre kombëtare për ta zbatuar këtë Direktivë brenda 18 muajve pas datës së njoftimit të saj dhe e informojnë menjëherë Komisionin për këtë.

Dispozitat e ndryshuara gjatë këtij afati zbatohen brenda 24 muajve pas këtij njoftimi.

Neni 11

Me të marrë njoftim për këtë Direktivë, Shtetet Anëtare kujdesen që t'i komunikohen Komisionit tekstet e dispozitave kryesore të akteve ligjore, nënligjore apo administrative që miratojnë në fushën që mbulon kjo Direktivë.

Neni 12

Kjo Direktivë u drejtohet Shteteve Anëtare.

Bërë në Bruksel, më 30 maj 1978.

Për Këshillin

Presidenti